Numër: 01-473 Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 merr:

V E N D I M

I. **Akreditohet dhe Validohet** "British Academy of Tecnology" Sh.P.K. Adresa: "Njësia of British Gymnasium of Teknolgy (BGT) Rr.Lidhja e Pejës, 10000 Prishtinë, Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare (01.09.2026 – 30.08.2029), me kualifikimin:

Teknologji e Informacionit, niveli IV sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), me numër total të kredive 180, kualifikim i bazuar në: Kualifikime Kombëtare të Kombinuara (C). Institucioni mund të realizojë procesin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional deri me njëzet e gjashtë (26) nxënës në një klase, dhe mund të ofroj deri ne katër (4) klase brenda vitit, që në total bëjnë 104 nxënës (4x26=104) nxënës për një vit shkollor.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së kolegjit "Britush Academy of Teknology" të parashtruar në AKK, për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin: **Teknologji e Informacionit.** Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 26.04.2026 për kualifikimin: **Teknologji e Informacionit,** vizitës të realizuar me datën: 28.04.2026 dhe 21.05.2026 dhe përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 21.05.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.
AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "British Academy of Tecnology"
- Arkivit të AKK.